



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.358/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025, i datës 25.10.2025, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 29.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.358/2025, datë 27.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 27.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.358/2025 e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se ankesa ka të bëjë me votimin me asistencë në shumë Komuna të Republikës së Kosovës, edhe në Komunën e Malishevës dhe se kjo për shkak të keqpërdorimit të së drejtës së votimit, respektivisht të votimit me asistencë, ka shkaktuar devijim, degradim dhe cenim të integritetit të procesit zgjedhor të mbajtur më 12 tetor 2025. Tutje në ankese ka theksuar se, është numër i madh i votave me asistencë në vendvotimet në Komunën e Malishevës dhe se pjesa apo përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës ka ndikuar drejtpërdrejtë në përjashtimin e kandidatëve të tjerë nga gara demokratike, duke arritur rezultate që sigurojnë fitoren pa balotazh, pra duke përjashtuar raundin e dytë të votimit. Përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës arrin në 9,32% të të gjitha votave të vlefshme, nga 20,465 vota të vlefshme në komunën e Malishevës, 1908 janë vota me asistencë. Në vendvotime të ndryshme, të selektuara si dëshmi konkrete, përqindja e votave me asistencë arrin deri mbi 20%, me arsyetimin në mbi 90% të rasteve votuesi/ja „nuk sheh" dhe „nuk din". Nga numri i përgjithshëm i vendvotimeve në komunën e Malishevës, në 37 vendvotime, që përbën rrafsh 50% të të gjitha vendvotime në këtë komunë, numri i votave me asistencë shtrihet nga mbi 10% deri në 21.30%. Në vijim të ankesës

pala ankuese ka paraqitur të gjitha vendvotimet ku përqindja e votave me asistencë është mbi 10%. Në VV 3002/01 nga 167 vota 19 me asistencë, apo 11.37 %; në VV 3002/04 nga 138 vota, 16 me asistencë, apo 11.60%; në VV 3003/01, nga 273 vota, 29 me asistencë, apo 11.62 %; në VV 3003/02, nga 320 vota, 38 me asistencë, apo 11.87%; njëjtë në VV 3003/02, nga 320 vota, 38 me asistencë, apo 11.87%; në VV 3003/04 nga 316 vota, 41 me asistencë apo 12.97%; në VV 3004/02, nga 193 vota, 23 me asistencë, apo 11.91%, në VV 3005/01, nga 277 vota, me 59 asistencë, apo 21.30%; në VV 3005/02, nga 259 vota, 40 me asistencë, apo 15,44%; në VV 3006/01 nga 105 vota, 19 me asistencë, apo 18.09%; në VV 3007/01, nga 276 vota, 33 me asistencë, apo 11.95%; në VV 3007/02, nga 228 vota, 30 me asistencë, apo 13.15%; në VV 3008/01, nga 261vota, 36 me asistencë, apo 13.80%; në VV 3008/03, nga 251 vota, 51 me asistencë, apo 20.32%; në VV 3009/01 nga 370 vota, 49 me asistencë, apo 13.24%; në VV 3009/02 nga 375 vota, 71 me asistencë, apo 18.93%; në VV 3011/02 nga 333 vota, 41 me asistencë, apo 12.31%; në VV 3013/01 nga 225 vota, 33 me asistencë, apo 14.66%; në VV 3014/01 nga 337 vota, 39 me asistencë, apo 11.57%; në VV 3014/02 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3015/03 nga 423 vota, 44 me asistencë, apo 11,40%; në VV 3016/01 nga 233 vota, 24 me asistencë, apo 10.30%; në VV 3017/01 nga 206 vota, 22 me asistencë, apo 10.67%; në VV 3019/02 nga 270 vota, 33 me asistencë, apo 12.22%; në VV 3019/03 nga 215 vota, 26 me asistencë, apo 12.09%; në VV 3020/01 nga 160 vota, 30 me asistencë, apo 18.75%; në VV 3020/02 nga 133 vota, 21 me asistencë, apo 15,79%; në VV 3021/02 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3026/02 nga 236 vota, 25 me asistencë, apo 10.60%; në VV 3027/01 nga 140 vota, 21 me asistencë, apo 15.00%; në VV 3028/01 nga 188 vota, 26 me asistencë, apo 13.83%; në VV 3028/02 nga 211 vota, 32 me asistencë, apo 15.16%; në VV 3029/02 nga 338 vota, 35 me asistencë, apo 10.35%; në VV 3030/01 nga 273 vota, 40 me asistencë, apo 14.65%; në VV 3030/02 nga 194 vota, 22 me asistencë, apo 11.34%; në VV 3031/01 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3035/02 nga 324 vota, 29 me asistencë, apo 10.11%.

Tutje në ankese theksohet se sa për ilustrim shembull, dallimi midis vendvotimeve për sa i përket votimit me asistencë është jashtëzakonisht i madh. Ky është një krahasim shembull tipik, në VV 3005/01, që nga 277 vota, janë 59 me asistencë, apo 21.30% !!! Në po të njëjtën Komunë me rrethana të ngjashme ekonomike, shoqërore, gjeografike, arsimore e shëndetësore, kemi VV 3010/01 me 306 votues, nga ta 4 me asistencë, apo 1.30%, sikurse edhe VV 3021/01 me 310 vota të vlefshme dhe vetëm 4 me asistencë, që bën 1,29% që mund të jenë afër logjikës së shëndoshë, edhe pse edhe në këto vendvotime arsyetimi është i kundërligjshëm dhe kundër kushtetues. Nuk ka asnjë shpjegim shkencor, shoqëror, politik apo statistikor që mund të arsyetojë votimin me asistencë për shkak se 'nuk sheh' , 'nuk di shkrim lexim'. Po të nisemi nga statistikat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe në Departamentin për Pensione të Ministrisë së Financave, në komunën e Malishevës janë të regjistruar 96 persona të verbër, një numër i përafërt, pra diku rreth 100 persona janë, sipas statistikave me të pamur të dobësuar afër verbërisë, por në asnjë rrethanë nuk janë rreth 900 persona të verbër apo me të pamur të dobësuar, siç vërehet nga librat e votimit në dispozicion, Ndërsa, në kundërshtim me çdo logjikë dhe statistikë zyrtare, numri i personave analfabetë del të jetë rreth 800 persona. Natyrisht, për një numër personash, votues/e me asistencë nuk është shënuar asnjë arsyetim, në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren, që kërkojnë arsyetim të qartë dhe të detajuar, të

përcjelle me dëshmi, Nga e tëra sa u tha më lartë, duke vepruar në këtë mënyrë : anëtarët e Këshillit të Vendvotimit vëzhguesit, votuesit dhe asistuesit, kanë bërë shkelje të Nenit 45, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 6, par. 2: "Vota është personale, e barabartë e lirë dhe e fshehtë" Për të qenë një vote e lirë ajo duhet të plotësojë në mënyrë kumulative elementet përbërëse të parimit kushtetues e ligjor, Vota duhet të jetë 'e fshehtë', pra askush tjetër, në asnjë mënyrë dhe rrethanë, nuk ka të drejtë të shohë dhe di shprehjen e preferencën konkrete të votuesit/es, pra se si voton votuesi/ja në rastin konkret. Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 6, par. 2 dhe Neni 89 [E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës], paragrafi 3, 4, 5, 6 dhe 10, në asnjë normë të Ligjit nuk parashihet prania fizike e një personi tjetër, asistuesit/es në kabinën e votimit kur votuesi/ja shënjon preferencën e vet në fletëvotim. Në asnjë situatë dhe në asnjë rrethanë.

Me këto veprime po ashtu Këshillat e Vendvotimeve të lartë cekura kanë bërë shkelje të Nenit 10 [E drejta e votës dhe fshehtësia e votës], paragrafët 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10 të Rregullores Zgjedhore nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Duke kërkuar nga PZAP të anulojë pjesërisht Vendimin e KQZ Nr. 01/ 3018 - 2025, të datës 25.10.2025, Për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kryetar Komune, të mbajtura më 12 tetor 2025, Të urdhëroje KQZ-në për rivotim në të gjitha Vendvotimet e cekura në këtë Ankesë: të përcjellë në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës të gjitha rastet me elemente të veprës penale, të shqiptojë sanksionet e parapara që bien në kompetencat e PZAP për shqiptimin e gjobave.

Në përgjigje në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, sqaron se bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, si dhe Procedura e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim e miratuar në KQZ me datën 12.08.2025, Nr.01/2051/2025 (shih procedurën e bashkangjitur), përcaktohet procesi i votimit me asistencë. Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës ka gjetur se:

Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se është numër i madh i votave me asistencë në vendvotimet në Komunën e Malishevës dhe se pjesa apo përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës ka

ndikuar drejtpërdrejtë në përjashtimin e kandidatëve të tjerë nga gara demokratike, duke arrite rezultate që sigurojnë fitoren pa balotazh, pra duke përjashtuar raundin e dytë të votimit, dhe se përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës arrin në 9,32% të të gjitha votave të vlefshme, nga 20,465 vota të vlefshme në komunën e Malishevës, 1908 janë vota me asistencë, ku përqindja e votave me asistencë arrin deri mbi 20%, me arsyetimin në mbi 90% të rasteve votuesi/ja „nuk sheh” dhe „nuk din” pas mbylljes së vendvotimit lidhur me asistim të votimit, është e parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Me dispozitën e nenit 102.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet që: *“çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”*. Ndërsa paragrafi 5 i po të njëjtit nen parasheh që: *“KQZ bën përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve.”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Paneli vlerëson se, ankesa e ankuesit është e paraqitur pas afatit ligjor, kjo pasi që, pretendimet ankimore të palës ankuese kanë të bëjnë me parregullsitë që kanë ndodhur ditën e zgjedhjeve të mbajtura me datë 12.10.2025 për shkak të numrit të lartë të asistimit të votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe së Qendra e Votimit është mbyllur me datë 12.10.2025, ku pala e cila ka pretenduar se i janë shkelur të drejtat e tij me rastin e votimit të asistuar, ka pasur të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit 48 orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ndërsa ankesa është dorëzuar më datë 27.10.2025, e në anën tjetër parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Paneli ka vlerësuar se, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ankesa është dorëzuar në PZAP, më datë 27.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese lidhet me procesit zgjedhor të ditës së zgjedhjeve i cili është mbyllur më datën 12.10.2025 në ora 19.00, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesave PZAP nuk i ka shqyrtuar, sepse fillimisht ankesa është ekzaminuar në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme, Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.358/2025, datë 29.10.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.107/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.358/2025, të datës 29.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 07.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.Anr.358/2025, të datës 29.10.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZL.Anr.358/2025, të datës 29.10.2025, është vendosur: "HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.358/2025, datë 27.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi i PZAP është i pabazuar faktikisht, i paarsyeshëm ligjërisht dhe jo profesional, duke pretenduar se LVV ankesën kundër vendimit të KQZ-së Nr.01/3018-2025 të datës 25.10.2025, në lidhje me votimin me asistencë në Komunën e Malishevës në Zgjedhjet Lokale më datë 12.10.2025 e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 48 orësh, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të anuloi vendimin e PZAP, ZL.Anr.358/2025, datë 27.10.2025, ashtu që të urdhëroj anulimin e pjesërishtëm të vendimit të KQZ Nr.01/3018-2025 të datës



25.10.2025, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kryetar Komune, të mbajtura më 12 tetor 2025, si dhe të urdhëroj KQZ-në për rivotim në të gjitha vendvotimet e cekura në ankesë për Komunën e Malishevës.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe theksoi se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka paraqitë ankesë ndaj vendimit ZL.Anr.358/2025, ndërsa ka pretenduar se gabimisht i është referuar vendimit ZL.Anr.375/2025, andaj ka propozuar që ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.358/2025, i datës 29.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës për qartësuar faktin se ndaj cilit vendim ka paraqitë ankesë Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me aktin përcjellës të datës 06.11.2025, subjektit politik në fjalë i ka kthyer ankesën në plotësim në mënyrë që të qartësohet se cili vendim është atakuar me ankesë.

Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me plotësimin e datës 07.11.2025 ka njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës se ankesa i referohet vendimit ZL.Anr.358/2025, në lidhje me Komunën e Malishevës, ndërsa gabimisht në ankesë i është referuar vendimit ZL.Anr.375/2025, me pretendim se i njëjti ka qenë gabim teknik.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe plotësimit të ankesës, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me datë 27.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.358/2025 e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se ankesa ka të bëjë me votimin me asistencë në shumë Komuna të Republikës së Kosovës, edhe në Komunën e Malishevës dhe se kjo për shkak të keqpërdorimit të së drejtës së votimit, respektivisht të votimit me asistencë, ka shkaktuar devijim, degradim dhe cenim të integritetit të procesit zgjedhor të mbajtur më 12 tetor 2025. Tutje në ankesë ka theksuar se, është numër i madh i votave me asistencë në vendvotimet në Komunën e Malishevës dhe se pjesa apo përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës ka ndikuar drejtpërdrejtë në përjashtimin e kandidatëve të tjerë nga gara demokratike, duke arritur rezultate që sigurojnë fitoren pa balotazh, pra duke përjashtuar raundin e dytë të votimit. Përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës arrin në 9,32% të të gjitha votave të vlefshme, nga 20,465 vota të vlefshme në komunën e Malishevës, 1908 janë vota me asistencë. Në vendvotime të ndryshme, të selektuara si dëshmi konkrete, përqindja e votave me asistencë arrin deri mbi 20%, me arsyetimin në mbi 90% të rasteve votuesi/ja „nuk sheh" dhe nuk din". Nga numri i përgjithshëm i vendvotimeve në komunën e Malishevës, në 37 vendvotime, që përbën rrafsh 50% të të gjitha vendvotime në këtë komunë, numri i votave me asistencë shtrihet nga mbi 10% deri në 21.30%. Në vijim të ankesës pala ankuese ka paraqitur të gjitha vendvotimet ku përqindja e votave me asistencë është mbi 10%. Në VV 3002/01 nga 167 vota 19 me asistencë.



apo 11.37 %; në VV 3002/04 nga 138 vota, 16 me asistencë, apo 11.60%; në VV 3003/01, nga 273 vota, 29 me asistencë, apo 11.62 %; në VV 3003/02, nga 320 vota, 38 me asistencë, apo 11.87%; njëjtë në VV 3003/02, nga 320 vota, 38 me asistencë, apo 11.87%; në VV 3003/04 nga 316 vota, 41 me asistencë apo 12.97%; në VV 3004/02, nga 193 vota, 23 me asistencë, apo 11.91%, në VV 3005/01, nga 277 vota, me 59 asistencë, apo 21.30%; në VV 3005/02, nga 259 vota, 40 me asistencë, apo 15.44%; në VV 3006/01 nga 105 vota, 19 me asistencë, apo 18.09%; në VV 3007/01, nga 276 vota, 33 me asistencë, apo 11.95%; në VV 3007/02, nga 228 vota, 30 me asistencë, apo 13.15%; në VV 3008/01, nga 261 vota, 36 me asistencë, apo 13.80%; në VV 3008/03, nga 251 vota, 51 me asistencë, apo 20.32%; në VV 3009/01 nga 370 vota, 49 me asistencë, apo 13.24%; në VV 3009/02 nga 375 vota, 71 me asistencë, apo 18.93%; në VV 3011/02 nga 333 vota, 41 me asistencë, apo 12.31%; në VV 3013/01 nga 225 vota, 33 me asistencë, apo 14.66%; në VV 3014/01 nga 337 vota, 39 me asistencë, apo 11.57%; në VV 3014/02 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3015/03 nga 423 vota, 44 me asistencë, apo 11,40%; në VV 3016/01 nga 233 vota, 24 me asistencë, apo 10.30%; në VV 3017/01 nga 206 vota, 22 me asistencë, apo 10.67%; në VV 3019/02 nga 270 vota, 33 me asistencë, apo 12.22%; në VV 3019/03 nga 215 vota, 26 me asistencë, apo 12.09%; në VV 3020/01 nga 160 vota, 30 me asistencë, apo 18.75%; në VV 3020/02 nga 133 vota, 21 me asistencë, apo 15,79%; në VV 3021/02 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3026/02 nga 236 vota, 25 me asistencë, apo 10.60%; në VV 3027/01 nga 140 vota, 21 me asistencë, apo 15.00%; në VV 3028/01 nga 188 vota, 26 me asistencë, apo 13.83%; në VV 3028/02 nga 211 vota, 32 me asistencë, apo 15.16%; në VV 3029/02 nga 338 vota, 35 me asistencë, apo 10.35%; në VV 3030/01 nga 273 vota, 40 me asistencë, apo 14.65%; në VV 3030/02 nga 194 vota, 22 me asistencë, apo 11.34%; në VV 3031/01 nga 311 vota, 39 me asistencë, apo 12.54%; në VV 3035/02 nga 324 vota, 29 me asistencë, apo 10.11%.

Tutje në ankesë është theksuar se sa për ilustrim shembull, dallimi midis vendvotimeve për sa i përket votimit me asistencë është jashtëzakonisht i madh. Ky është një krahasim shembull tipik, në VV 3005/01, që nga 277 vota, janë 59 me asistencë, apo 21.30% !!! Në po të njëjtën komunë me rrethana të ngjashme ekonomike, shoqërore, gjeografike, arsimore e shëndetësore, kemi VV 3010/01 me 306 votues, nga ta 4 me asistencë, apo 1.30%, sikurse edhe VV 3021/01 me 310 vota të vlefshme dhe vetëm 4 me asistencë, që bën 1,29% që mund të jenë afër logjikës së shëndoshë, edhe pse edhe në këto vendvotime arsyetimi është i kundërligjshëm dhe kundër kushtetues. Nuk ka asnjë shpjegim shkencor, shoqëror, politik apo statistikor që mund të arsyetojë votimin me asistencë për shkak se 'nuk sheh', 'nuk di shkrim lexim'. Po të nisemi nga statistikat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe në Departamentin për Pensione të Ministrisë së Financave, në komunën e Malishevës janë të regjistruar 96 persona të verbër, një numër i përafërt, pra diku rreth 100 persona janë, sipas statistikave me të pamur të dobësuar afër verbërisë, por në asnjë rrethanë nuk janë rreth 900 persona të verbër apo me të pamur të dobësuar, siç vërehet nga librat e votimit në dispozicion, Ndërsa, në kundërshtim me çdo logjikë dhe statistikë zyrtare, numri i personave analfabetë del të jetë rreth 800 persona. Natyrisht, për një numër personash, votues/e me asistencë nuk është shënuar asnjë arsyetim, në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren, që kërkojnë arsyetim të qartë dhe të detajuar, të përcjelle me dëshmi, Nga e tëra sa u tha më lartë, duke vepruar në këtë mënyrë anëtarët e Këshillit të Vendvotimit vëzhguesit, votuesit dhe asistuesit, kanë bërë shkelje të Nenit 45, par




2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 6, par. 2: "Vota është personale, e barabartë e lirë dhe e fshehtë" Për të qenë një vote e lirë ajo duhet të plotësojë në mënyrë kumulative elementet përbërëse të parimit kushtetues e ligjor, Vota duhet të jetë 'e fshehtë', pra askush tjetër, në asnjë mënyrë dhe rrethanë, nuk ka të drejtë të shohë dhe di shprehjen e preferencën konkrete të votuesit/es, pra se si voton votuesi/ja në rastin konkret. Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 6, par. 2 dhe Neni 89 [E Drejta e Votës dhe Fshtësia e Votës], paragrafi 3, 4, 5, 6 dhe 10, në asnjë normë të Ligjit nuk parashihet prania fizike e një personi tjetër, asistuesit/es në kabinën e votimit kur votuesi/ja shënon preferencën e vet në fletëvotim. Në asnjë situatë dhe në asnjë rrethanë.

Me këto veprime po ashtu Këshillat e Vendvotimeve të lartë cekura kanë bërë shkelje të Nenit 10 [E drejta e votës dhe fshtësia e votës], paragrafët 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10 të Rregullores Zgjedhore nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Duke kërkuar nga PZAP të anulojë pjesërisht Vendimin e KQZ Nr. 01/ 3018 - 2025, të datës 25.10.2025, Për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kryetar Komune, të mbajtura më 12 tetor 2025, Të urdhëroje KQZ-në për rivotim në të gjitha Vendvotimet e cekura në këtë Ankesë: të përcjellë në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës të gjitha rastet me elemente të veprës penale, të shqiptojë sanksionet e parapara që bien në kompetencat e PZAP për shqiptimin e gjobave.

Në përgjigje në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, ka sqaruar se bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, si dhe Procedura e votimit dhe Numërimit në Vendvotim e miratuar në KQZ me datën 12.08.2025, Nr.01/2051/2025 (shih procedurën e bashkangjitur), përcaktohet procesi i votimit me asistencë. Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se është numër i madh i votave me asistencë në vendvotimet në Komunën e Malishevës dhe se pjesa apo përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës ka ndikuar drejtpërdrejtë në përjashtimin e kandidatëve të tjerë nga gara demokratike, duke arritë rezultate që sigurojnë fitoren pa balotazh, pra duke përjashtuar raundin e dytë të votimit, dhe se përqindja e votave me asistencë në Komunën e Malishevës arrin në 9,32% të të gjitha votave të vlefshme, nga 20,465 vota të vlefshme në komunën e Malishevës, 1908 janë vota me asistencë, ku përqindja e votave me asistencë arrin deri mbi 20%, me arsyetimin në mbi 90%



të rasteve votuesi/ja, „nuk sheh" dhe „nuk din" pas mbylljes së vendvotimit lidhur me asistim të votimit, është e parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj", si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se "PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor".

Me dispozitën e nenit 102.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet që: "çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj". Ndërsa paragrafi 5 i po të njëjtit nen parasheh që: "KQZ bën përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve."

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Paneli vlerëson se, ankesa e ankuesit është e paraqitur pas afatit ligjor, kjo pasi që, pretendimet ankimore të palës ankuese kanë të bëjnë me parregullsitë që kanë ndodhur ditën e zgjedhjeve të mbajtura me datë 12.10.2025 për shkak të numrit të lartë të asistimit të votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe së Qendra e Votimit është mbyllur me datë 12.10.2025, ku pala e cila ka pretenduar se i janë shkelur të drejtat e tij me rastin e votimit të asistuar, ka pasur të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit 48 orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ndërsa ankesa është dorëzuar më datë 27.10.2025, e në anën tjetër parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor. Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura, Paneli ka vlerësuar se, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ankesa është dorëzuar në PZAP, më datë 27.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese lidhet me procesin zgjedhor të ditës së zgjedhjeve i cili është mbyllur më datën 12.10.2025 në ora 19.00, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me hedhjen si të pasafatshme të ankesës Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale të



mbajtura më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Kjo për faktin se në këtë rast ka rezultuar se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ankesën që i referohet parregullsive që kanë ndodhur ditën e zgjedhjeve të mbajtura me datë 12.10.2025 për shkak të numrit të lartë të asistimit të votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe së Qendra e Votimit në Komunën e Malishevës e ka paraqitur pas afatit ligjor.

Me nenin 119 paragrafi 1 i LZP-së, është përcaktuar se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj", Ndërsa me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, është përcaktuar se: "PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor". Gjykata Supreme e Kosovës, duke marrë për bazë dispozitat e lartcekura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës e ka vlerësuar të drejtë vendimin e PZAP, me të cilin subjektit politik në fjalë i është hedhë ankesa si e pasafatshme, kjo pasi që parregullsitë për të cilat Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) pretendon se janë bërë në ditën e zgjedhjeve lokale me datë 12.10.2025, lidhur me votat me asistencë për Komunën e Malishevës, ka pasur të drejtë që ti atakoj, respektivisht të paraqes ankesë kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025, brenda afatit prej 48 orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ndërsa ankesën e ka dorëzuar më datë 27.10.2025, që rezulton se e njëjta ankesë është paraqitë jashtë afatit ligjor.

Po ashtu me nenin 102.1 i të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcaktohet se: "Çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj". Ndërsa paragrafi 5 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se: "KQZ bën përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve." Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar dispozitat e lartcekura, e duke marrë parasysh edhe përgjigjen në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, ka rezultuar se nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025, andaj ka vlerësuar se subjektit politik në fjalë me të drejtë i është hedhë ankesa si e pasafatshme nga PZAP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesit për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se ankesa kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot.01/3018/2025 është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orëve, andaj me të drejtë PZAP e ka hedhë poshtë ankesën si



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kryetari i kolegjit,

Faton Bajrami



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
POÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlaščeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-107/2025

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmerimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebnje precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

ART674KIH

07.11.2025

Numri i shtojcave:

2

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima)

07.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je pismeno primilo u zameni)

07.11.2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač. napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Fm 1208